



Council of Europe Treaty Series — № 210

Konventa e Këshillit të Europës për
parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër
grave dhe dhunës në familje

Stamboll, 11.V.2011

The official languages of the Council of Europe are English and French (Article 12 of the Statute of the Council of Europe). Only the treaties published by the Secretary General of the Council of Europe, each in a separate booklet of the "European Treaty Series" (ETS) continued since 2004 by the "Council of Europe Treaty Series" (CETS), are deemed authentic. The translation presented here is for information only.

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke rikujtuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS Nr. 5, 1950) dhe Protokollet e saj, Kartën Sociale Europiane (ETS Nr. 35, 1961, të rishikuar në 1996, ETS Nr. 163), Konventën e Këshillit të Europës mbi Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS Nr. 197, 2005) dhe Konventën e Këshillit të Europës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (CETS Nr. 201, 2007);

Duke rikujtuar rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës: Rekomandimin Rec (2002)5 mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, Rekomandimin CM/Rec (2007)17 mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, Rekomandimin CM/Rec (2010)10 mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes, dhe rekomandime të tjera përkatëse;

Duke marrë parasysh numrin në rritje të praktikave gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila cakton standarde të rëndësishme në fushën e dhunës kundër grave;

Duke patur parasysh Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave ("CEDAW", 1979) dhe Protokollin e saj Opsional (1999), si dhe Rekomandimin e Përgjithshëm Nr 19 të Komitetit CEDAW mbi dhunën kundër grave, Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (1989) dhe Protokollet e saj Opsionale (2000) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006);

Duke patur parasysh Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (2002);

Duke rikujtuar parimet bazë të të drejtës ndërkombëtare humanitare, dhe veçanërisht Konventën e Gjenevës (IV) në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë (1949) dhe Protokollet e saj Shtesë I dhe II (1977);

Duke dënuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

Duke pranuar se realizimi i barazisë *de jure* dhe *de facto* midis burrave dhe grave është një element kyç në parandalimin e dhunës kundër grave;

Duke pranuar se dhuna kundër grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e të plotë të grave;

Duke pranuar natyrën strukturore të dhunës kundër grave si dhunë gjinore, dhe se dhuna kundër grave është një prej mekanizmave thelbësorë socialë me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat;

Duke pranuar me shqetësim të thellë se gratë dhe vajzat janë shpesh të ekspozuara ndaj formave serioze të dhunës, si për shembull dhuna në familje, ngacmimi seksual, përdhunimi, martesat e detyruara, krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit "nder" dhe gjymtimi i organeve gjinitale, që përbën shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave;

Duke pranuar shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura që prekin popullsinë civile, veçanërisht gratë, në formën e një përdhunimi të përhapur ose sistematik dhe dhunës seksuale dhe mundësisë për rritje të dhunës gjinore si gjatë edhe pas konflikteve;

Duke pranuar se gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat ndaj një rreziku më të lartë të dhunës gjinore;

Duke pranuar se dhuna në familje prek gratë në mënyrë disproporcionale, dhe se burrat gjithashtu mund të jenë viktimat të dhunës në familje;

Duke pranuar se fëmijët janë viktimat të dhunës në familje, përfshirë rastet si dëshmitarë të dhunës në familje;

Duke aspiruar të krijojnë një Europë pa dhunë kundër grave dhe pa dhunë në familje,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Kapitulli I – Qëllimet, përkufizimet, barazia dhe mosdiskriminimi, detyrime të përgjithshme

Neni 1 – Qëllimet e Konventës

1 Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

b kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;

c hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

d nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

e ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përjasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

2 Me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të dispozitave të saj nga Palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm specifik monitorimi.

Neni 2 – Objekti i Konventës

1 Kjo Konventë zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale.

2 Palët inkurajohen të zbatojnë këtë Konventë për të gjitha viktimat e dhunës në familje. Palët i kushtojnë vëmendje të veçantë grave viktimat të dhunës gjinore, në zbatim të dispozitave të kësaj Konvente.

3 Kjo Konventë zbatohet në kohë paqeje dhe në situata konflikti të armatosur.

Neni 3 – Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Konvente:

a “dhunë kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private;

b “dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;

c “gjini” nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë;

d “dhunë gjinore kundër grave” nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale;

e “viktimë” nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat a dhe b;

f “gra” përfshin vajzat nën moshën 18 vjeç.

Neni 4 – Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për çdokënd, veçanërisht gratë, për të jetuar pa dhunë në sferën publike, si dhe në atë private.

2 Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe marrin pa vonesë masat legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i parandaluar, veçanërisht me anë të:

- shprehjes së parimit të barazisë midis burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke garantuar realizimin praktik të këtij parimi;
- ndalimit të diskriminimit kundër grave, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të sanksioneve, sipas rastit;
- shfuqizimit të ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë gratë.

3 Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

4 Masat e veçanta që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna gjinore nuk konsiderohen diskriminim sipas kushteve të kësaj Konvente.

Neni 5 – Detyrimet e shtetit dhe masat paraprake

1 Palët i shmangen përfshirjes në akte dhune kundër grave dhe garantojnë që autoritetet Shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorë të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë joshitetërorë.

Neni 6 – Politikat me ndjeshmëri gjinore

Palët marrin përsipër të përfshijnë një perspektivë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e ndikimit të dispozitave të kësaj Konvente dhe të nxisin dhe zbatojnë në mënyrë efektive politikat e barazisë midis burrave dhe grave, dhe fuqizimin e grave.

Kapitulli II – Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave

Neni 7 – Politikat gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të miratuar dhe zbatuar politika mbarëkombëtare efektive, gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara që përfshijnë të gjitha masat përkatëse për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe që ofrojnë reagim holistik ndaj dhunës kundër grave.

2 Palët garantojnë që politikat e përmendura në paragrafin 1 të vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave dhe të zbatohen me anë të bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse.

3 Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, si për shembull agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile.

Neni 8 – Burimet financiare

Palët shpërndajnë burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e duhur të politikave, masave dhe programeve të integruara për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato që janë kryer nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile.

Neni 9 – Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile

Palët pranojnë, nxisin dhe mbështesin, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile, aktive në luftën e dhunës kundër grave dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata.

Neni 10 – Organi bashkërendues

1 Palët caktojnë ose krijojnë një ose më shumë organe zyrtare përgjegjëse për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga kjo Konventë. Këto organe bashkërendojnë mbledhjen e të dhënave të përmendura në Nenin 11, si dhe analizojnë dhe publikojnë rezultatet e tyre.

2 Palët garantojnë që organet e caktuara ose të krijuara sipas këtij neni të marrin informacion të një natyre të përgjithshme mbi masat e marra sipas Kapitullit VIII.

3 Palët garantojnë që organet e caktuara ose të krijuara sipas këtij neni të kenë aftësinë për të komunikuar drejtpërdrejt dhe për të forcuar marrëdhëniet me homologët e tyre tek Palët e tjera.

Neni 11 – Mbledhja dhe kërkimi i të dhënave

1 Për qëllim të zbatimit të kësaj Konvente, Palët marrin përsipër:

a të mbledhin të dhëna përkatëse të zberthyer statistikore, në intervale të rregullta kohore, në lidhje me rastet e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente;

b të mbështesin kërkimin në fushën e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, me qëllim shqyrtimin e arsyeve fillestare dhe pasojave, niveleve të shpeshësisë dhe dënimit, si dhe efikasitetit të masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

2 Palët përpiqen të kryejnë studime të bazuara në popullsi, në intervale të rregullta kohore, për të vlerësuar shpeshësinë dhe tendencat në të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

3 Palët sigurojnë grupin e ekspertëve të përmendur në Nenin 66 të kësaj Konvente, me informacionin e mbledhur sipas këtij neni, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mundësimin e vlerësimit krahasues ndërkombëtar.

4 Palët garantojnë që informacioni i mbledhur sipas këtij neni t'i vihet në dispozicion publikut.

Kapitulli III – Parandalimi

Neni 12 – Detyrimet e përgjithshme

1 Palët marrin masat e nevojshme për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me synim çrrënjosjen e paragjyqimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente nga çdo person fizik ose juridik.

3 Çdo masë e marrë sipas këtij kapitulli merr në konsideratë nevojat specifike të personave pa mbrojtje për shkak të rrethanave të veçanta dhe i japin prioritet të drejtave të të gjitha viktimave.

4 Palët marrin masat e nevojshme për të inkurajuar të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht burrat dhe djemtë, që të kontribuojnë në mënyrë aktive në parandalimin e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

5 Palët garantojnë që kultura, zakonet, feja, tradita ose i ashtuquajturi “nder” të mos konsiderohen si justifikim për çdo akt dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente.

6 Palët marrin masat e nevojshme për të promovuar programe dhe aktivitete për fuqizimin e grave.

Neni 13 – Rritja e ndërgjegjësimit

1 Palët promovojnë ose realizojnë rregullisht dhe në të gjitha nivelet, fushata ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit, duke përfshirë ato në bashkëpunim me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, sipas rastit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe perceptimin nga publiku i gjerë, në lidhje me manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, pasojat e tyre për fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë.

2 Palët garantojnë nivel të lartë shpërndarjeje për publikun e gjerë, të informacionit mbi masat e vëna në dispozicion për parandalimin e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 14 – Arsimi

1 Sipas rastit, Palët marrin hapat e nevojshme për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje të tilla si barazia midis burrave dhe grave, rolet gjinore të pasteriotipizuara, respekti i ndërsjellë, zgjidhja e konflikteve pa dhunë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhuna gjinore kundër grave dhe e drejta për integritet personal, të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore.

2 Palët marrin hapat e nevojshme për të promovuar parimet e përmendura në paragrafin 1 në mjediset informale arsimore, si dhe në mjedise sportive, kulturore dhe argëtuese dhe media.

Neni 15 – Trajnimi i profesionistëve

1 Palët sigurojnë ose forcojnë trajnimin e duhur për profesionistët përkatës që merren me viktimat ose autorët e të gjitha akteve të dhunës të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, mbi parandalimin dhe zbulimin e një shkeljeje të tillë, barazinë midis burrave dhe grave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, si dhe mënyrën e parandalimit të viktimizimit dytësor.

2 Palët inkurajojnë që trajnimi i përmendur në paragrafin 1 të përfshijë trajnim për bashkëpunimin e bashkërenduar midis shumë agjencive, për të lejuar një trajtim gjithëpërfshirës dhe të duhur të referimeve në rastet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 16 – Ndërhyrja parandaluese dhe programet e trajtimit

1 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë edukimin e autorëve të dhunës në familje që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes.

2 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe trajtimi që synojnë parandalimin e autorëve, veçanërisht autorëve të krimeve seksuale, nga përsëritja e veprës.

3 Në marrjen e masave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, Palët garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e viktimave të jenë shqetësim parësor dhe, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.

Neni 17 – Pjesëmarrja e sektorit privat dhe medias

1 Palët nxisin sektorin privat, sektorin e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit dhe medias, në lidhje me lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e tyre, për të marrë pjesë në përpunimin dhe zbatimin e politikave dhe për të caktuar udhëzime dhe standarde vetërregullatore për parandalimin e dhunës kundër grave dhe rritjen e respektit për dinjitetin e tyre.

2 Palët zhvillojnë dhe promovojnë, në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat, aftësitë midis fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve për mënyrën si të trajtojnë mjedisin e informacionit dhe komunikimit që ofron akses ndaj përmbajtjes degraduese të një natyre seksuale ose të dhunshme, e cila mund të ishte e dëmshme.

Kapitulli IV – Mbrojtja dhe mbështetja

Neni 18 – Detyrimet e përgjithshme

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të mbrojtur të gjitha viktimat nga akte të mëtejshme dhune.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera në pajtim me ligjin e brendshëm, për të garantuar ekzistencën e mekanizmave të duhur për të parashikuar bashkëpunim efektiv midis të gjitha agjencive shtetërore përkatëse, duke përfshirë gjyqësorin, prokurorët publikë, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet vendore dhe rajonale, si dhe organizatat joqeveritare dhe organizata dhe ente të tjera përkatëse, në mbrojtje dhe mbështetje të viktimave dhe dëshmitarëve të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato me anë të referencës ndaj shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse të specializuara, siç përcaktohen hollësisht në Nenet 20 dhe 22 të kësaj Konvente.

3 Palët garantojnë që masat e marra sipas këtij kapitulli:

- të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës;
- të bazohen në një përjasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social;
- të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor;
- të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktimave të dhunës;
- të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente;
- të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.

4 Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori veprave penale.

5 Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktimat të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.

Neni 19 – Informimi

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të marrin informacion të mjaftueshëm dhe në kohë, në një gjuhë që kuptojnë, në lidhje me shërbimet e disponueshme mbështetëse dhe masat ligjore.

Neni 20 – Shërbimet e përgjithshme mbështetëse

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime të tilla si konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime sociale dhe në kujdes shëndetësor, dhe që shërbimet të kenë burime të mjaftueshme dhe profesionistët të jenë trajnuar për të ndihmuar viktimat dhe për t'i drejtuar ata tek shërbimet përkatëse.

Neni 21 – Ndihma për ankesat individuale/kolektive

Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.

Neni 22 – Shërbimet mbështetëse të specializuara

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të siguruar ose caktuar, në një shpërndarje të mjaftueshme gjeografike, shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata mbështetëse të specializuara për çdo viktimitë që i nënshtrohet një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente.

2 Palët sigurojnë ose caktojnë shërbime mbështetëse të specialisteve femra për të gjitha gratë, viktimat të dhunës, dhe fëmijët e tyre.

Neni 23 – Strehat

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e strehave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme e në numër të mjaftueshëm, për të ofruar strehim të sigurt dhe për të përdorur përjasje proaktive ndaj viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre.

Neni 24 – Linjat telefonike të ndihmës

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të vendosur linja telefonike falas të ndihmës mbarëkombëtare të pandërprerë (24/7) për të ofruar konsulencë për telefonuesit, fshehtësi ose respektim të anonimatit të tyre, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 25 – Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale

Palët marrin masa të nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e një numri të mjaftueshëm të qendrave referuese të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme për dhunën seksuale ose krizën nga përdhunimi, për viktimat, për të parashikuar vizita mjekësore dhe mjekoligjore, mbështetje për traumat dhe këshillim për viktimat.

Neni 26 – Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave, të merren në konsideratë të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2 Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë këshillimin e duhur psikosocial për dëshmitarët fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe marrin në konsideratë interesat më të mira të fëmijës.

Neni 27 – Raportimi

Palët marrin masat e nevojshme për të inkurajuar çdo dëshmitar në kryerjen e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente ose që ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ky akt mund të kryhet, ose që priten akte të mëtejshme dhune, të njoftojë organizatat ose autoritetet kompetente.

Neni 28 – Raportimi nga profesionistët

Palët marrin masat e nevojshme për të garantuar që rregullat e fshehtësisë të vendosura nga ligji i brendshëm mbi profesionistë të caktuar, sipas kushteve përkatëse, të mos pengojnë mundësinë e njoftimit të tyre pranë organizatave ose autoriteteve kompetente, nëse kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune i mbuluar nga objekti i kësaj Konvente dhe priten akte të mëtejshme të rënda dhune.

Kapitulli V – Ligji i së drejtës dhe detyrimeve

Neni 29 – Paditë civile dhe mjetet ligjore

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve Shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre.

Neni 30 – Kompensimi

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë të drejtë për të kërkuar kompensim nga autorët për çdo shkelje të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë.

2 Kompensimi i mjaftueshëm nga Shteti i jepet atyre që kanë pësuar dëme të rënda trupore ose dëme ndaj shëndetit, në shkallën që dëmi nuk mbulohet nga burime të tjera, si për shembull masa për autorët e veprave penale, sigurimin ose masa sociale ose shëndetësore të financuara nga shteti. Kjo nuk pengon Palët që të kërkojnë kthim për kompensimin e dhënë nga autori i veprës penale, për sa kohë që i kushtohet rëndësia e duhur sigurisë së viktimës.

3 Masat e marra sipas paragrafit 2 garantojnë dhënien e kompensimit brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Neni 31 – Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që, në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtave të vizitave të fëmijëve, të merren në konsideratë incidentet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që ushtrimi i vizitave ose të drejta të tjera kujdestarie të mos rrezikojnë të drejtat dhe sigurinë e viktimës ose fëmijëve.

Neni 32 – Pasojat civile të martesave të detyruara

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që martesat e detyruara të mund të jenë të pavlefshme, të anulohen ose zgjidhen pa barra të papërshtatshme financiare ose administrative të vendosura ndaj viktimës.

Neni 33 – Dhuna psikologjike

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e dëmtimit të qëllimshëm të integritetit psikologjik të një personi nëpërmjet shtrëngimit ose kërcënimeve.

Neni 34 – Sjelljet kërcënuese

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e përfshirjes së qëllimshme e të vazhdueshme në sjellje kërcënuese të drejtuar ndaj një personi tjetër, që i shkakton atij ose asaj frikë për sigurinë personale.

Neni 35 – Dhuna fizike

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e kryerjes së qëllimshme të akteve të dhunës fizike kundër një personi tjetër.

Neni 36 – Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

- a përfshirja në depërtim të detyruar vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër me pjesë trupore ose objekte;
- b përfshirja me një person në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale;
- c nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të detyruara të një natyre seksuale.

2 Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekstin e rrethanave më të afërta.

3 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që dispozitat e paragrafit 1 të zbatohen edhe për aktet e kryera kundër ish bashkëshortëve/partnerëve ose bashkëshortëve/partnerëve aktualë, të njohur nga ligji i brendshëm.

Neni 37 – Martesa e detyruar

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin detyrimin të qëllimshëm të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e tërheqjes së qëllimshme të një të rrituri ose fëmije për të shkuar në territorin e një Pale ose Shteti të ndryshëm nga ai ku ai ose ajo banon, me qëllim detyrimin e një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

Neni 38 – Gjymtimi i organeve gjenitale femërore

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

- a prerja, infibulimi ose kryerja e ndonjë gjymtimi tjetër për të tërë ose një pjesë të buzëve të mëdha, buzëve të vogla ose klitorit të gruas;
- b shtrëngimi ose kërkesa ndaj një gruaje që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën a;
- c provokimi, shtrëngimi ose kërkesa ndaj një vajze që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën a.

Neni 39 – Aborti dhe sterilizimi i detyruar

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

- a kryerja e abortit të një gruaje pa pëlqimin e saj paraprak;
- b kryerja e një operacioni kirurgjikal që ka qëllimin ose efektin e ndërprerjes së kapacitetit të një gruaje për të qenë riprodhuese në mënyrë natyrale, pa pëlqimin e saj paraprak ose kuptimin e procedurës.

Neni 40 – Ngacmimi seksual

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiçësor, degradues, poshtëruës ose ofendues, t'i nënshtrohet një sanksioni penal ose sanksioni tjetër ligjor.

Neni 41 – Dhënia e ndihmës ose bashkëpunimi dhe tentativa

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar si veprë penale, kur kryhet qëllimisht, dhënien e ndihmës ose bashkëpunimin për kryerjen e veprave penale të përcaktuara në pajtim me Nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të kësaj Konvente.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, tentativat për të kryer veprat penale të përcaktuara në pajtim me Nenet 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të kësaj Konvente.

Neni 42 – Justifikimet e papranueshme për krime, duke përfshirë krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder”

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që, në procedimet penale të filluara pas kryerjes së një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, kultura, zakoni, feja, tradita ose i ashtuquajturi “nder” të mos konsiderohen si justifikime për këto akte. Kjo mbulon veçanërisht pretendimet që viktimat ka shkelur normat ose zakonet kulturore, fetare, sociale ose tradicionale të sjelljes së duhur.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që nxitja e një fëmije për të kryer ndonjë prej akteve të përmendura në paragrafin 1 të mos cenojë përgjegjësinë penale të atij personi për aktet e kryera.

Neni 43 – Aplikimi i veprave penale

Veprat e përcaktuara në pajtim me këtë Konventë aplikohen pavarësisht nga natyra e marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe shkelësit.

Neni 44 – Juridiksioni

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer:

- a në territorin e tyre; ose
- b në bordin e një anijeje që ngre flamurin e tyre; ose
- c në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të tyre; ose
- d nga një prej shtetasve të tyre; ose
- e nga një person i cili ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.

2 Palët përpiqen të marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer kundër një prej shtetasve të tyre ose një personi që ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.

3 Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre të mos varet nga fakti që veprat janë dënuar në territorin ku janë kryer.

4 Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre në lidhje me pikat d dhe e të paragrafit 1 të mos varet nga fakti që ndjekja penale mund të fillojë vetëm pas kallëzimit nga viktimia të veprës penale ose parashtrimin të informacionit nga Shteti i vendit ku është kryer vepra penale.

5 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë, në rastet kur autori i dyshuar është i pranishëm në territorin e tyre dhe ata nuk e ekstradojnë tek një Palë tjetër, vetëm për shkak të kombësisë së tij/të saj.

6 Kur më shumë se një Palë kërkon juridiksionin mbi një vepër të dyshuar të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, Palët e përfshira, sipas rastit, konsultohen me njëra tjetrën, me synim përcaktimin e juridiksionit më të përshtatshëm për ndjekje penale.

7 Pa cenuar rregullat e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar nga një Palë në pajtim me ligjin e saj të brendshëm.

Neni 45 – Sanksionet dhe masat

1 Palët marrin masat e nevojshme ose masa të tjera për të garantuar që veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë, të dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe frenuese, duke marrë parasysh shkallën e kryerjes së tyre. Këto sanksione përfshijnë,

sipas rastit, dënime që përfshijnë heqjen e lirisë, të cilat mund të përbëjnë shkak për ekstradim.

2 Palët mund të marrin masa të tjera në lidhje me autorët e veprave penale, të tilla si:

- monitorimi ose mbikëqyrja e personave të dënuar;
- tërheqja e të drejtave prindërore, nëse interesat më të mira të fëmijës, që mund të përfshijnë sigurinë e viktimës, nuk mund të garantohen në një mënyrë tjetër.

Neni 46 – Rrethanat rënduese

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që rrethanat e mëposhtme, në masën që tashmë nuk janë elementë përbërës të veprës penale, në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese në përcaktimin e dënimit në lidhje me veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë:

- a vepra penale është kryer kundër një ish bashkëshorti ose partneri ose bashkëshorti ose partneri aktual të njohur nga ligji i brendshëm, nga një anëtar familjeje, një person që bashkëjeton me viktimën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;
- b vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur;
- c vepra penale është kryer kundër një personi të pambrojtur për shkak të rrethanave të veçanta;
- d vepra është kryer kundër ose në prani të një fëmije;
- e vepra penale është kryer nga dy ose më shumë njerëz që veprojnë së bashku;
- f vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele ekstreme dhune;
- g vepra është kryer me përdorimin ose kërcënimin e armës;
- h vepra penale ka shkaktuar dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik të viktimës;
- i autori është dënuar më parë për vepra penale të një natyre të ngjashme.

Neni 47 – Dënimet e dhëna nga Pala tjetër

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar mundësinë e marrjes parasysh të vendimeve të formës së prerë të marra nga Pala tjetër në lidhje me veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë në përcaktimin e dënimit.

Neni 48 – Ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që nëse urdhërohet pagesa e një gjobe, të merret në konsideratë aftësia e autorit të veprës penale për të marrë përsipër detyrimet e tij ose të saj financiare ndaj viktimës.

Kapitulli VI – Hetimi, ndjekja penale, ligji procedural dhe masat mbrojtëse

Neni 49 – Detyrimet e përgjithshme

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që hetimet dhe procedimet gjyqësore në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente të kryhen pa vonesë të panevojshme ndërsa merren parasysh të drejtat e viktimës gjatë të gjitha fazave të procedimeve penale.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera, në përputhje me parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe duke marrë parasysh perceptimin gjinor të dhunës, për të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive të veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 50 – Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të përgjigjen ndaj të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme duke ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëhershme për viktimat.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të angazhohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme në parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë përdorimin e masave parandaluese operationale dhe mbledhjen e provave.

Neni 51 – Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 merr parasysh siç duhet, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, faktin se autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konventë zotërojnë ose kanë akses të armëve të zjarrit.

Neni 52 – Urdhrat e jashtëzakonshëm të ndalimit

Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që autoriteteve kompetente u është dhënë fuqia për të urdhëruar, në situata të rrezikut të menjëhershëm, autorin e dhunës në familje që të lërë vendbanimin e viktimës ose personit në rrezik për një periudhë të mjaftueshme kohe dhe të ndalojë autorin të hyjë në vendbanimin e ose kontaktojë viktimën ose personin në rrezik. Masat e marra në zbatim të këtij neni, i japin përparësi sigurisë së viktimave apo personave në rrezik.

Neni 53 – Urdhra shtrëngues dhe mbrojtës

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që urdhra të përshtatshëm shtrëngues dhe mbrojtës janë të vlefshme për viktimat e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që urdhrat shtrënguese ose mbrojtës të përmendur në paragrafin 1 janë:

- të vlefshëm për mbrojtje të menjëhershme dhe pa barriera të panevojshme financiare apo administrative, të vendosura mbi viktimën;
- lëshohen për një periudhë të caktuar, ose derisa të modifikohen ose të përmbushen;
- kur është e nevojshme, lëshohen në bazë *ex parte* që ka efekt të menjëhershëm;
- të vlefshëm pavarësisht nga, ose krahas, procedimeve të tjera ligjore;
- lejohen të paraqiten në procedimet ligjore të mëtejshme.

3 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që shkeljet e urdhrave shtrëngues ose mbrojtës të nxjerra në pajtim me paragrafin 1 i nënshtrohen sanksioneve penale ose të tjera ligjore efektive, proporcionale dhe frenuese.

Neni 54 – Hetimet dhe prova

Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që, në çdo procedim civil apo penal, provat në lidhje me historinë seksuale dhe sjellje të viktimës lejohen vetëm kur është e përshtatshme dhe e nevojshme.

Neni 55 – Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*

1 Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente nuk do të jenë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktima e tërheq deklaratën ose ankesën e tij ose saj.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 56 – Masat e mbrojtjes

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti:

a duke ofruar mbrojtjen e tyre, si dhe atë të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimi dhe viktimizimi i përsëritur;

b duke siguruar që viktimat të informohen, të paktën në rastet kur viktima dhe familja mund të jetë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht;

c duke i informuar ata, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm, për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe shqyrtimin e ankesës së tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimit ose të procedimit, dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatin e çështjes së tyre;

d duke bërë të mundur që viktimat, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, të dëgjohen, të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim;

e duke u siguruar viktimave shërbime mbështetëse të duhura në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;

f duke siguruar që masat mund të miratohen për të mbrojtur jetën private dhe imazhin e viktimës;

g duke siguruar që kontakti ndërmjet viktimave dhe autorëve të veprës brenda gjykatës dhe zyrave të agjencisë së zbatimit të ligjit të shmangët kur është e mundur;

h duke u siguruar viktimave përkthyes të pavarur dhe kompetentë, kur viktimat janë palë në procedim ose kur ata sigurojnë prova;

i duke bërë të mundur që viktimat të dëshmojnë, sipas rregullave të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar të veprës, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, kur janë në dispozicion.

2 Një fëmijë viktimë dhe dëshmitar i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje i sigurohen, kur është e përshtatshme, masa të posaçme mbrojtjeje duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Neni 57 – Ndihma ligjore

Palët sigurojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë ligjore falas për viktimat sipas kushteve të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm.

Neni 58 - Parashkrimi

Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe të tjera për të siguruar që parashkrimi për fillimin e çdo procedimi ligjor në lidhje me veprat penale të parashikuara në përputhje me Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, do të vazhdojë për një periudhë kohore që është e mjaftueshme dhe proporcionale me seriozitetin e veprës në fjalë, për të lejuar fillimin efikas të procedimeve, pasi viktima ka arritur moshën madhore.

Kapitulli VII – Emigrimi dhe azili

Neni 59 – Statusi i vendbanimit

1 Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimave vendbanimi i të cilëve varet nga statusi i bashkëshortit ose partnerit siç njihet nga ligji i brendshëm, në rast të zgjidhjes së martesës ose marrëdhënies, u jepet në rast të rrethana veçanërisht të vështira, me kërkesë, një leje qëndrimi autonom, pavarësisht nga kohëzgjatja e martesës apo marrëdhënies. Kushtet në lidhje me dhënien dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit autonom parashikohen nga ligji i brendshëm.

2 Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të garantuar që viktimat mund të sigurojnë pezullimin e procedurave të dëbimit të filluara në lidhje me një status vendbanimi të varur nga ajo e bashkëshortit ose partnerit siç njihet nga ligji i brendshëm për t'u dhënë atyre mundësinë që të aplikojnë për një leje qëndrimi autonom.

3 Palët lëshojnë një leje qëndrimi të rinovueshme për viktimat në një nga dy situatat e mëposhtme, ose në të dyja:

a kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm për shkak të situatës së tyre personale;

b kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm me qëllim të bashkëpunimit të tyre me autoritetet kompetente në hetim ose procedimin penal.

4 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e martesës së detyruar të sjellë në një shtet tjetër, për qëllim martese dhe të cilët, si rezultat, kanë humbur statusin e tyre të vendbanimit në shtetin ku ata zakonisht banojnë, mund të rifitojnë këtë status.

Neni 60 – Kërkesat për azil me bazë gjinore

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar se dhuna me bazë gjinore kundër grave mund të njihet si një formë persekutimi brenda kuptimit të Nenit 1, A (2), të Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe si një formë e dëmtimit të rëndë që shkakton mbrojtje plotësuese / mbështetëse.

2 Palët sigurojnë që një interpretim me ndjeshmëri gjinore të jepet për secilin nga arsyet e Konventës dhe se aty ku është përcaktuar që persekutimi i mundshëm ndodh për një ose më shumë nga këto arsye, aplikuesve do t'u jepet statusi i refugjatëve në bazë të instrumenteve të zbatueshme përkatëse.

3 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të zhvilluar procedurat e pranimit dhe shërbime mbështetëse me ndjeshmëri gjinore për azilkërkuessit si dhe udhëzimet gjinore dhe procedurat për azil me ndjeshmëri gjinore, duke përfshirë përcaktimin e statusit të refugjatëve dhe kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 61 – Mbrojtja e refugjatëve

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të respektuar parimin e mbrojtjes së refugjatëve në përputhje me detyrimet ekzistuese sipas ligjit ndërkombëtar.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e dhunës ndaj grave që kanë nevojë për mbrojtje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen nën asnjë rrethanë në çdo vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ata mund t'i nënshtrohen torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues apo dënimit.

Kapitulli VIII – Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 62 – Parimet e përgjithshme

1 Palët bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, dhe përmes zbatimit të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale për bashkëpunimin në çështje civile dhe penale, marrëveshjeve të arritura në bazë të legjislacionit uniform ose reciprok dhe ligjeve të brendshme, në masën më të gjerë të mundshme, me qëllim:

- a parandalimin, luftën dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente;
- b mbrojtjen dhe sigurimin e ndihmës për viktimat;
- c hetimin ose procedimin në lidhje me veprat penale të parashikuara në përputhje me këtë Konventë;
- d zbatimin e vendimeve përkatëse civile dhe penale, të lëshuara nga autoritetet gjyqësore të Palëve, duke përfshirë urdhrat mbrojtës.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë dhe të kryer në territorin e një Pale të ndryshëm nga ai ku ata banojnë, mund të bëjnë një ankesë para autoriteteve kompetente të Shtetit të tyre të vendbanimit.

3 Nëse një Palë që ofron ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale, ekstradimin ose zbatimin e vendimeve civile ose penale të dhëna nga një Palë tjetër në këtë Konventë të

kushtëzuar nga ekzistenca e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për bashkëpunim të tillë juridik nga një Palë, me të cilin nuk ka lidhur një marrëveshje të tillë, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, ekstradimin ose zbatimin e vendimeve civile ose penale të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

4 Palët përpiqen të harmonizojnë, kur është e përshtatshme, parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në programe të asistencës për zhvillim të dhëna në interes të Shteteve të treta, duke përfshirë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me Shtete të treta me qëllim lehtësimin e mbrojtjes së viktimave në përputhje me Nenin 18, paragrafi 5.

Neni 63 – Masat që lidhen me personat në rrezik

Kur një Palë, mbi bazën e informacionit në dispozicion të tij, ka arsye të mjaftueshme të besojë se një person është në rrezik të menjëhershëm për të qenë subjekt i ndonjë akti dhune të përmendur në Nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente në territorin e një Pale tjetër, Pala që ka informacion inkurajohet ta transmetojë atë pa vonesë për këtë të fundit me qëllim që të sigurojë se masat e duhura të mbrojtjes janë marrë. Kur është e zbatueshme, ky informacion do të përfshijë detajet mbi dispozitat ekzistuese të mbrojtjes në interes të personit në rrezik.

Neni 64 – Informimi

1 Pala e kërkuar informon menjëherë Palën kërkuese për rezultatin përfundimtar të masës së ndërmarrë në këtë kapitull. Gjithashtu Pala e kërkuar informon menjëherë Palën kërkuese për çdo rrethanë që e bën të pamundur realizimin e masës së kërkuar ose që mund ta vonojë atë në mënyrë të konsiderueshme.

2 Një Palë mund, brenda kufijve të ligjit të tij të brendshëm, pa kërkesë paraprake, t'i përcjellë Palës tjetër informacionin e marrë në kuadër të hetimeve të saj, kur ajo gjykon se zbulimi i informacioneve të tilla mund të ndihmojë Palën marrëse në parandalimin e veprave penale të parashikuara në përputhje me këtë Konventë ose në fillimin apo kryerjen e hetimeve ose të procedimeve në lidhje me vepra të tilla penale, ose mund të çojë në një kërkesë për bashkëpunim nga kjo Palë sipas këtij kapitulli.

3 Një Palë që merr çdo informacion në përputhje me paragrafin 2 ia paraqet këtë informacion autoriteteve kompetente të saj, në mënyrë që të ndërmerren procedime nëse ato konsiderohen të përshtatshme, ose që ky informacion të merret në konsideratë në lidhje me procedimet përkatëse civile dhe penale.

Neni 65 – Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale ruhen dhe përdoren në përputhje me detyrimet e ndërmarra nga Palët në bazë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS nr 108).

Kapitulli IX – Mekanizmi i monitorimit

Neni 66 – Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

1 Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (më poshtë referuar si "GREVIO") monitoron zbatimin e kësaj Konvente nga Palët.

2 GREVIO përbëhet nga një minimum prej 10 anëtarësh dhe një maksimum prej 15 anëtarësh, duke marrë parasysh një balancë gjinore dhe gjeografike, si dhe ekspertizën multidisiplinore. Anëtarët e saj zgjidhen nga Komiteti i Palëve nga radhët e kandidatëve të nominuar nga Palët për një mandat prej katër vjetësh, i rinovueshëm një herë, dhe zgjidhen nga shtetasit e Palëve.

3 Zgjedhja fillestare e 10 anëtarëve, mbahet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Zgjedhja e 5 anëtarëve shtesë mbahet pas ratifikimit ose aderimit të 25-të.

4 Zgjedhja e anëtarëve të GREVIO bazohet në parimet e mëposhtme:

a ata zgjidhen në bazë të një procedure transparente nga radhët e personave me karakter të lartë moral, të njohur për kompetencën e tyre të pranuar në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, ose të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave, ose që kanë demonstruar përvojë profesionale në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;

b dy anëtarë të GREVIO nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit Shtet;

c ata duhet të përfaqësojnë sistemet kryesore ligjore;

d ata duhet të përfaqësojnë aktorët dhe agjencitë përkatëse në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

e ata veprojnë në kapacitetin e tyre individual dhe janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre, dhe janë në dispozicion për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.

5 Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GREVIO përcaktohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit dhe marrjes së pëlqimit unanim të Palëve, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

6 GREVIO miraton rregullat e veta të procedurës.

7 Anëtarët e GREVIO, dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, siç përcaktohet në Nenin 68, paragrafët 9 dhe 14, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në shtojcën e kësaj Konvente.

Neni 67 – Komiteti i Palëve

1 Komiteti i Palëve përbëhet nga përfaqësuesit e Palëve në Konventë.

2 Komiteti i Palëve mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Takimi i tij i parë zhvillohet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në mënyrë që të zgjedhë anëtarët e GREVIO. Ai takohet më pas sa herë që një e treta e Palëve, Presidenti i Komitetit të Palëve ose Sekretari i Përgjithshëm e kërkojnë këtë.

3 Komiteti i Palëve miraton rregullat e veta të procedurës.

Neni 68 – Procedura

1 Palët i dorëzojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, bazuar në një pyetësor të përgatitur nga GREVIO, një raport mbi masat legislative dhe të tjera që i bëjnë dispozitat e kësaj Konvente të zbatueshme, për shqyrtim nga GREVIO.

2 GREVIO merr në shqyrtim raportin e paraqitur në përputhje me paragrafin 1 me përfaqësues të Palës së interesuar.

3 Procedurat e vlerësimit të mëtejshëm ndahen në raunde, kohëzgjatja e së cilës përcaktohet nga GREVIO. Në fillim të çdo raundi GREVIO zgjedh dispozitat e veçanta mbi të cilat bazohet procedura e vlerësimit dhe dërgon një pyetësor.

4 GREVIO përcakton mjetet e duhura për të kryer këtë procedure monitorimi. Ajo në veçanti mund të miratojë një pyetësor për çdo raund vlerësimi, e cila shërben si një bazë për procedurën e vlerësimit të zbatimit nga Palët. Ky pyetësor i drejtohet të gjitha Palëve. Palët i përgjigjen këtij pyetësori, si dhe çdo kërkesë tjetër për informacion nga GREVIO.

5 GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, si dhe nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

6 GREVIO shqyrton siç duhet informacionin ekzistues në dispozicion nga instrumentet dhe organet e tjera rajonale dhe ndërkombëtare në fushat që hyjnë brenda objektit të kësaj Konvente.

7 Kur miratohet një pyetësor për çdo raund vlerësimi, GREVIO i kushton vëmendje të duhur mbledhjes së të dhënave ekzistuese dhe kërkimit shkencor nga Palët, siç përmendet në Nenin 11 të kësaj Konvente.

8 GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga Komisioneri i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Asambleja Parlamentare dhe organet përkatëse të specializuara të Këshillit të Europës, si edhe ato të krijuara në bazë të instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Ankesat e paraqitura në këto organe dhe rezultati i tyre i vihen në dispozicion GREVIO.

9 GREVIO mund të organizojë, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe me ndihmën e ekspertëve të pavarur kombëtarë, vizita në vende, nëse informacioni i marrë është i pamjaftueshme, ose në rastet e parashikuara në paragrafin 14. Gjatë këtyre vizitave, GREVIO mund të asistohet nga specialistë në fusha të veçanta.

10 GREVIO përgatit një projekt raport që përmban analizën e saj në lidhje me zbatimin e dispozitave mbi të cilat bazohet vlerësimi, si dhe sugjerimet dhe propozimet e saj në lidhje me mënyrën në të cilën Pala e interesuar mund të trajtojë problemet që janë identifikuar. Projekt raporti i dërgohet për komente Palës që i nënshtrohet vlerësimit. Komentet e saj merren parasysh nga GREVIO kur miraton raportin e tij.

11 Në bazë të të gjitha informacioneve të marra dhe komenteve nga Palët, GREVIO miraton raportin dhe konkluzionet e tij lidhur me masat e marra nga Pala e interesuar për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente. Ky raport dhe konkluzionet i dërgohen Palës së interesuar dhe Komitetit të Palëve. Raporti dhe konkluzionet e GREVIO bëhen publike, që nga miratimi i tyre, së bashku me komentet e mundshme nga Pala e interesuar.

12 Pa cenuar procedurën e paragrafëve 1 deri në 8, Komiteti i Palëve mund të miratojë, në bazë të raportit dhe konkluzioneve të GREVIO, rekomandimet drejtuar kësaj Pale (a) në lidhje me masat që duhen marrë për zbatimin e konkluzioneve të GREVIO, nëse është e nevojshme duke caktuar një datë për paraqitjen e informacioneve mbi zbatimin e tyre, dhe (b) duke synuar nxitjen e bashkëpunimit me atë Palë për zbatimin e duhur të kësaj Konvente.

13 Në qoftë se GREVIO merr informacion të besueshëm që tregon një situatë ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve të rënda të Konventës, ajo mund të kërkojë paraqitjen e menjëhershme të një raporti të veçantë në lidhje me masat e marra për të parandaluar një model serioz, në masë ose të vazhdueshme të dhunës ndaj grave.

14 Duke pasur parasysh informacionin e paraqitur nga Pala e interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të tij, GREVIO mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e tij për të kryer një hetim dhe për të raportuar menjëherë në GREVIO. Kur garantohet dhe me pëlqimin e Palës, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e saj.

15 Pas shqyrtimit të rezultateve të hetimit të referuar në paragrafin 14, GREVIO ia transmeton këto rezultate Palës së interesuar dhe, kur është e përshtatshme, Komitetit të Palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës së bashku me komentet dhe rekomandimet.

Neni 69 – Rekomandime të përgjithshme

GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 70 - Përfshirja parlamentare në monitorim

1 Parlamentet kombëtare ftohen të marrin pjesë në monitorimin e masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

2 Palët paraqesin raportet e GREVIO në parlamentet e tyre kombëtare.

3 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës ftohet të bëjë rregullisht vlerësime mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Kapitulli X – Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Neni 71 – Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1 Kjo Konventë nuk i cenon detyrimet që rrjedhin nga instrumentet e tjera ndërkombëtare në të cilat Palët në këtë Konventë janë Palë ose bëhen Palë dhe të cilat përmbajnë dispozita mbi çështje të rregulluara nga kjo Konventë.

2 Palët në këtë Konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me njëri-tjetrin në çështje që trajtohen në këtë Konventë, me qëllim plotësimin ose përf forcimin e dispozitave të tij ose lehtësimin e zbatimit të parimeve të shprehura në të.

Kapitulli XI – Amendimet e Konventës

Neni 72 – Amendimet

1 Çdo propozim për amendim të kësaj Konvente të paraqitur nga një Palë i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe i përcillet nga ana e saj apo e tij Shteteve anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkruesi, çdo Palë, Bashkimit Europian, çdo Shteti të ftuar për nënshkrimin e kësaj Konvente në përputhje me dispozitat e Nenit 75, dhe çdo Shteti të ftuar për aderim në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e Nenit 76.

2 Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës shqyrton amendimin e propozuar dhe, pas konsultimit të Palëve në këtë Konventë që nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës, mund të miratojë amendimin me shumicën e parashikuar në Nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës.

3 Teksti i çdo amendimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 2, u përcillet Palëve për pranim.

4 Çdo amendim i miratuar në përputhje me paragrafin 2 hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe një mujore pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre.

Kapitulli XII – Dispozitat përfundimtare

Neni 73 – Efektet e kësaj Konvente

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë dispozitat e ligjit të brendshëm dhe instrumentet detyruese ndërkombëtare, të cilat janë tashmë në fuqi ose mund të hyjnë në fuqi, sipas të cilave të drejta më të favorshme u janë dhënë ose do t'u jepen personave në parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Neni 74 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1 Palët në çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin ose interpretimin e dispozitave të kësaj Konvente së pari duhet të kërkojnë ta zgjidhin atë me anë të bisedimit, pajtimit, arbitrazhit ose me çdo metodë tjetër të zgjidhjes paqësore të pranuar me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre.

2 Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të përcaktojë procedurat e zgjidhjes që të jenë në dispozicion për përdorim nga Palët në mosmarrëveshje nëse ata do të binin dakord për këtë.

Neni 75 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1 Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe Bashkimi Europian.

2 Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3 Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës në të cilën 10 nënshkruesit, duke përfshirë të paktën 8 Shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur nga Konventa në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

4 Në lidhje me çdo Shtet të referuar në paragrafin 1 apo Bashkimin Europian, i cili shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 76 – Aderimi në Konventë

1 Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit të Palëve në këtë Konventë dhe marrjen e pëlqimit të tyre unanim, mund të ftojë çdo Shtet jo anëtar të Këshillit të Europës, e cila nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, për të aderuar në këtë Konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës, dhe me votë unanime të përfaqësuesve të palëve të drejtë për t'u ulur në Komiteti i Ministrave.

2 Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës

Neni 77 – Zbatimi territorial

1 Çdo Shtet apo Bashkimi European mund, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të caktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.

2 Çdo Palë mund, në çdo datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilëve ajo është e autorizuar për të ofruar garanci. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3 Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm mund, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 78 – Rezervat

1 Asnjë rezervë nuk mund të bëhet në lidhje me çdo dispozitë të kësaj Konvente, me përjashtimet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3.

2 Çdo shtet ose Bashkimi European mund, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të mos zbatojë ose të zbatojë vetëm në raste ose kushte të caktuara dispozitat e parashtruara në:

- Nenin 30, paragrafi 2;
- Nenin 44, paragrafët 1.e, 3 dhe 4;
- Nenin 55, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 35 për shkeljet e lehta;
- Nenin 58 në lidhje me Nenet 37, 38 dhe 39;
- Nenin 59.

3 Çdo shtet ose Bashkimi European mund, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të parashikojë sanksione jo-penale, në vend të sanksioneve penale, për sjellje të referuara në Nenet 33 dhe 34.

4 Çdo Palë mund ta tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Kjo deklaratë hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 79 – Vlefshmëria dhe shqyrtimi i rezervave

1 Rezervat e përmendura në Nenin 78, paragrafët 2 dhe 3, janë të vlefshme për një periudhë prej pesë vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me Palën e interesuar. Sidoqoftë, këto rezerva mund të rinovohen për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

2 Tetëmbëdhjetë muaj para datës së mbarimit të afatit të rezervës, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton për mbarimin e këtij afati Palën e interesuar. Jo më vonë se tre muaj para mbarimit të afatit, Pala njofton Sekretarin e Përgjithshëm se ajo do e mbajë, ndryshojë ose tërheqë rezervën e saj. Në mungesë të një njoftimi nga Pala e interesuar,

Sekretariati i Përgjithshëm informon atë Palë se rezerva e saj konsiderohet të jetë zgjatur automatikisht për një periudhë prej gjashtë muajsh. Mosnjoftimi nga Pala e interesuar për qëllimin e saj për të mbajtur ose modifikuar rezervën e saj para mbarimit të kësaj periudhe bën që rezerva të mos jetë më e vlefshme.

3 Nëse një Palë bën një rezervë në përputhje me Nenin 78, paragrafët 2 dhe 3, ajo jep, para rinovimit të saj ose me kërkesë, një shpjegim për GREVIO, mbi arsyet që justifikojnë vazhdimin e saj.

Neni 80 – Denoncimi

1 Çdo Palë mund, në çdo kohë, të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2 Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tre mujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 81 – Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, Shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj, çdo nënshkrues, çdo Palë, Bashkimin Europian, dhe çdo shtet të ftuar për aderim në këtë Konventë për:

a çdo nënshkrim;

b depozitim të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me Nenet 75 dhe 76;

d çdo amendim të miratuar në përputhje me Nenin 72 dhe datën në të cilën ky amendim hyn në fuqi;

e çdo rezervë dhe tërheqje të rezervës të bërë në zbatim të Nenit 78;

f çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të Nenit 80;

g çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në [Stamboll], më [11] [Maj 2011], në anglisht dhe frëngjisht, ku të dy tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej Shteteve anëtare të Këshillit të Europës, Shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Bashkimit Europian dhe çdo Shteti të ftuar për aderim në këtë Konventë.

Shtojca – Privilegjet dhe imunitetet (Neni 66)

1 Kjo shtojcë zbatohet për anëtarët e GREVIO të përmendur në Nenin 66 të Konventës, si dhe për anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende. Për qëllim të kësaj shtojce, termi "anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende" përfshin ekspertë të pavarur vendas dhe specialistët të përmendur në Nenin 68, paragrafi 9, të Konventës, anëtarët e stafit të Këshillit të Europës dhe përkthyesit e punësuar nga Këshilli i Europës që shoqërojnë GREVIO gjatë vizitave të saj në vende.

2 Anëtarët e GREVIO dhe anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në lidhje me përgatitjen dhe kryerjen e vizitave në vende, si dhe ndjekjen e tyre, dhe që udhëtojnë në lidhje me këto funksione, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a. imunitet ndaj arrestimit ose ndalimit dhe ndaj sekuestrimit të bagazheve të tyre personale, dhe imunitet ndaj procesit ligjor të çdo lloji në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha aktet e realizuara nga ata në cilësinë zyrtare;

b përjashtim nga çdo kufizim të lirisë së lëvizjes në dalje nga dhe kthim në vendin e tyre të vendbanimit, dhe hyrjet e daljet nga vendi në të cilin ata ushtrojnë funksionet e tyre, dhe nga regjistrimi i të huajve në vendin të cilin ata po vizitojnë, ose nëpërmjet të cilit ata po kalojnë në ushtrim të funksioneve të tyre;

3 Gjatë udhëtimeve të ndërmarra në ushtrim të funksioneve të tyre, anëtarëve të GREVIO dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, në çështje të kontrollit doganor dhe të këmbimit, u jepen të njëjtat lehtësi si ato që u jepen përfaqësuesve të qeverive të huaja në detyrë të përkohshme zyrtare.

4 Dokumentet në lidhje me vlerësimin e zbatimit të Konventës të kryer nga anëtarët e GREVIO dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende janë të pacenueshme për aq sa ato lidhen me aktivitetin e GREVIO. Asnjë pengesë apo censurë nuk zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare të GREVIO ose komunikimeve zyrtare të anëtarëve të GREVIO dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende.

5 Për t'ju siguruar anëtarëve të GREVIO dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, lirinë e plotë të fjalës dhe pavarësinë e plotë në përmbushjen e detyrave të tyre, imuniteti ndaj procesit ligjor në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në përmbushjen e detyrave të tyre vazhdon t' u jepet, pavarësisht se personat në fjalë nuk janë më të angazhuar me përmbushjen e detyrave të tilla.

6 Privilegjet dhe imunitetet u jepen personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce në mënyrë që të garantojnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në interes të GREVIO dhe jo për përfitimin e tyre personal. Heqja e imuniteteve të personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës në çdo rast kur, sipas mendimit të tij ose të saj, imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe kur ajo mund të hiqet pa cenuar interesat e GREVIO.